



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2562/4 prot

Datë 06.11.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1127 /2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyzri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.11.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AA&P SHPK” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-81066-09-25-2023., me objekt “Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor”, me fond limit 3.872.440 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “2AS INVEST” SHPK, me Nipt M11803504B  
*Adresa: Lagjja 13, Plazh, Zona Kadastrale 8518, Nr.Pasurie 58/338+1-43, kati tetë, Durrës*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Patos.  
*Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos.*
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “AA&P” SHPK  
*Adresa:Njësia Bashkiake nr.6, Rr: "Tanush Frasheri", Pallati "B&K" konstrukt, Tiranë*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave*”

*“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

##### *Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

#### **II**

##### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.09.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-81066-09-25-2023, me objekt: “Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor”, me fond limit 3.872.440 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2. Në datë 06.10.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 17.10.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. "2 AS INVEST" SH.P.K	me ofertë	2.920.000 Lekë pa TVSh	skualifikuar
2. "MURATI" SH.P.K.	"	3.227.700	skualifikuar
3. "AA&P" SH.P.K	"	3.732.000	kualifikuar

II.4. Më datë 18.10.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesi paraprak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik "2 AS INVEST" SH.P.K me numër ankimi elektronik A/2023/3516, datë 20.10.2023, dhe me nr. 2562/2023 prot., datë 23.10.2023 për procedurën e prokurimit "*Procedurë e hapur e thjeshtuar*", me Nr. REF-81066-09-25-2023., me objekt "*Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor*", me fond limit 3.872.440 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "*Veprimet paraprake*" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2562/2 prot., datë 23.10.2023 lidhur me pretendimet mbi arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 2806/12 prot., datë 27.10.2023, protokolluar me tonën me nr.2562/3, datë 01.11.2023, autoriteti kontraktor ka paraqitur "*Informacion*" pranë Komisionit të Prokurimit Publik si dhe vendimin e KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke vendosur refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "2 AS INVEST" SHPK.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### Arsyeton

III.1. Në datën 29.09.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "*Procedurë e hapur e thjeshtuar*", me Nr. REF-81066-09-25-2023., me objekt "*Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor*", me fond limit 3.872.440 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

III.1.2. Në datë 06.10.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 17.10.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës duke i njoftuar me anë të

sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1.	“2 AS INVEST” SH.P.K	me ofertë	2.920.000	Lekë pa TVSh	skualifikuar
2.	“MURATI” SH.P.K.	“	3.227.700	“	skualifikuar
3.	“AA&P” SH.P.K	“	3.732.000	“	kualifikuar

III.1.4. Më datë 18.10.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesi paraprak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

III.1.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “2 AS INVEST” SH.P.K me numër ankimi elektronik A/2023/3516, datë 20.10.2023, dhe me nr. 2562/2023 prot., datë 23.10.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-81066-09-25-2023., me objekt “Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor”, me fond limit 3.872.440 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2562/2 prot., datë 23.10.2023 lidhur me pretendime për procedurën e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e operatorit ekonomik “2AS INVEST” SHPK mbi shfuqizim të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “AA&P” SHPK:

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërbushje të kriterëve si më poshtë vijon:

**2.3.4. Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat e kërkuara objekt prokurimi.**

**2.3.5. Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambjentet e magazinës pranë Bashkisë Patos brenda datës 06/10/2023 ora 11:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë:**

<i>Nr.</i>	<i>Nr. Anal.</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
1	treg	Ndriçues LED 50 W	copë	1
2	treg	Ndriçues LED 100 W	copë	1
4	treg	Ndriçues LED me Panel diellor	copë	1

*Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave dhe përshtatshmerinë që duhet të kenë në objektet ekzistuese ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.*

**Shënim:** *Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat e dorëzuara do ti kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

### **Ankimuesi kërkon:**

*AK të anulojë procedurën.*

*Të vlerësojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë.*

*Të skualifikohet AA&P SHPK.*

III.1.7. Nëpërmjet shkresës nr. 2806/12 prot., datë 27.10.2023, protokolluar me tonën me nr.2562/3, datë 01.11.2023, autoriteti kontraktor ka paraqitur “*Informacion*” pranë Komisionit të Prokurimit Publik si dhe vendimin e KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke vendosur refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “2 AS INVEST” SHPK.

III.1.8. Neni 24, pika 1, “*Komisioni i prokurimit Publik*” i Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.*”.

Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se: “*1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: “*1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

*2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.*”.

*3. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, e publikon në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të paktën të dhëna për:*

*a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;*

*b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit ( objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).*

4. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;

c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.

III.1.9. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

*1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

III.1.10 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të ofertave në SPE, Komisioni vëren se oferta e operatorit ekonomik ankimues është skualifikuar me arsye si vijon:

*Ju s’kualifikoheni pasi nuk plotësoni kriteret si më poshtë:*

• **Kriterin 2.3.4** Operatorët Ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat e kërkuara objekt prokurimi.

*Konkretisht ju për ndriçusit Led keni paraqitur një autorizim nga Shoqëria Bauled e cila deklarohet prodhuese. Por nga verifikimi i QKB-së së shoqëris Bauled ai figuron distributor. Në këtë rastë ju nuk keni provuar lidhjen e kësaj shoqëri që është distributore me prodhuesin e autorizuar për ndriçusit Led.*

• **Kriterin 2.3.5.** Operatorët Ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojë në ambjentet e magazinës pranë Bashkisë Patos brenda datës 01/09/2023 ora 11:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë. Mostrat e paraqitur nga ana juaj zeri nr. 3 nuk është sjellë sipas specifikimet teknike të përcaktuara në DST, është kërkuarë ngjyra e ndrucuesit 6000- 6500 K ndërkoh mostra përkon me ngjyrën 4000-4500 K referuar procesverbalit nr. 2447/12 Prot., datë 09.10.2023 të mbajtur nga komisioni i marrjes në dorzim të mostrave.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ankimues është njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor i cili ka vendosur për skualifikimin e ofertës së këtij të fundit. Brenda afateve të parashikuara të ankimit në nenin 110 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ankimuesi ka parashtruar pretendime vetëm mbi kualifikimin e operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Ligjvënësi në nenin 110 e vijues të

ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” ka parashikuar afate strikte mbi paraqitjen e ankesës, afate të cilat për nga natyra juridike janë prekluzive

Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se LPP parashikon në mënyrë të qartë se për çdo vendimmarrje të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë që rrezikojnë të dëmtohen nga ky vendim duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të ankimit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda afateve të parashikuara në LPP, duke respektuar të gjitha elementet formale sipas dispozitave ligjore. Operatori ekonomik ankimues “2 AS INVEST” SHPK, ka paraqitur pretendime vetëm mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “AA&P” SHPK dhe nuk ka kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, duke humbur kështu të drejtën për tu ankimuar për skualifikimin e tij brenda afateve ligjore të përcaktuara nga ligji.

Referuar përcaktimeve ligjore si më sipër cituar, kërkohet që ankimuesi, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të rregullohet përmes ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.1.11. Komisioni vëren se i vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është, që përmes ankimit ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit dhe nuk e ka kundërshtuar këtë fakt, duke humbur kështu të drejtën për tu ankimuar brenda afateve ligjore, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa kohë rezulton i skualifikuar dhe nuk e ka ankimuar arsyet e skualifikimit të ofertës së tij. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë për operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar, për sa kohë vetë rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt-ankimi, duke mos gëzuar asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi në kuptim të nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi,

*pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “2 AS INVEST” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-81066-09-25-2023., me objekt “Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor”, me fond limit 3.872.440 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 06.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “2 AS INVEST” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**

